



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 82/ 2011

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga, Rafet Haxhaj kryesues, Hasan Shala dhe Ferit Osmani, duke vendosur përkitazi për ankesën e subjektit politik Partia Demokratike e Ashkanlive të Kosovës (PDAK), për shkak të parregullsive gjatë procesit të numërimit të votave, në seancën e panelit të mbajtur me 13.01.2011, mori këtë:

V E N D I M

HIDHET poshtë ankesa si e palejuar e subjektit politik Partia Demokratike e Ashkanlive të Kosovës (PDAK).

A r s y e t i m

PZAP, ka pranuar një ankesë më datë 13.01.2011, nga subjekti politik PDAK, ne te cilën pretendohet se kanë ndodhur gabime gjatë numërimit të votave në komunën e Istogut, meqë rast subjektit politik Partia e Ashkanlive për Integrim (PAI), iu është shtuar numri i votave gabimisht që sipas rezultateve preliminare të shpallura më 13.12.2010 dhe më 11.01.2011 në shtypin Kosovar nga KQZ-ja, ky subjekt politik i ka pas në Istog 217 vota, menjëherë ka reaguuar KKZ-ja në Istog për këtë parregullsi sepse në fakt PAI në Istog i ka pas 20 vota e jo 217. Gabimet të njëjtës natyrë sipas parashtruesit të ankesës kanë ndodhur në fshatin Terpezë komuna e Vitisë në këtë rast subjektit politik PAI iu kanë përshkruar 165 vota. Subjekti politik PDAK kërkon nga PZAP-i që të merr parasysh problemin në fjalë.

Neni 105 paragrafi 1 i LZP-së, parasheh:

105.1 Ankesat lidhur me administrimin e numërimit në QNR dorëzohen me shkrim pranë PZAP-it brenda 24 orësh nga ndodhja e shkeljes së supozuar.

PZAP-i gjeti se;

- ankesa është e palejuar.

Nga shkresat e lëndës rrjedh, lidhur me pretendimet nga parashtruesi i ankesës, se janë bërë shkeljet e theksuar në ankesë në këtë fazë të procedurës nuk mund të vendoset për rezultatet e zgjedhjeve sepse këto rezultatet janë preliminare dhe si të tilla mund të ndryshojnë më shpalljen e rezultateve përfundimtare të zgjedhjeve.

Prandaj PZAP-i duke u bazuar në arsyet e cekuar më lartë e po ashtu në pajtim më dispozitat e cituara ligjore, në kuptim të nenit 115 paragrafi 1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoba e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashresa

A nr. 82/2011 më datën 13.01.2011

**Kryesuesi i Panelit
Rafet Haxhaj**

